

PLANI VJETOR

PËR VITIN 2020 NË LIDHJE ME PROCESIN E VENDIMARRJES

I

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është përgatitur plani vjetor për transparencën në procesin e vendimarrjes së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky plan përfshin informacionet për veprimtarinë ligjore sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 146/2014, datë 30.10.2014, ‘Për njoftimin dhe konsultimin publik’.

Përsa i përket veprimtarisë ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2020, më poshtë jepen të detajuara të gjitha veprimet që do të kryhen:

Titulli i projekt-aktit	Afati i paraqitjes në KM	Objektivi/qëllimi	Periudha e konsultimit publik	Mënyra e konsultimit publik.
Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësit Social në Republikën e Shqipërisë”.	Katër-mujori 2/2020	Objekti i këtij projektakti synon garantimin e një cilësie më të mirë të shërbimeve në fushën e punës sociale, sidomos në atë të shërbimeve sociale. Qëllimi i projektakti është miratimi i shtesave dhe ndryshimeve të Ligjit nr.163/2014 “Për urdhërin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	1.Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2.Tryezë e përbashkët/takime me palët e interesuara
Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” të ndryshuar”.	Katër-mujori 3/2020	Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, vendosjen në treg, importin, eksportin, tregtimin, përdorimin, farmakovigjilencën, publicitetin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me barnat për përdorim njerëzor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e shëndetit publik.	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	1.Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2.Tryezë e përbashkët/takime me palët e interesuara;

		Objekti i këtij projektakti synon që për barnat që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, standartizimi i procedurave të cilësisë do të jetë i njëjtë me atë të 39 shteteve anëtare të Farmakopesë Europiane.		
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8876, datë 4.04.2002 “Për Shëndetin Riprodhues” të ndryshuar.	Katër-mujori 3/2020	<p>Ky projektakt ka si qëllim Përditësimin e udhërrefyeseve, protokolleve klinike të shëndetit riprodhues me ndikim në fushat e shtatëzarisë së sigurt, uljes së vdekshmërisë amtare, foshnjore, mirëushqyerjes së nënës e fëmijës.</p> <p>Përditësimin e indikatorëve për monitorimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në këto dy fusha.</p> <p>Rishikimin e akteve ligjore për mbikqyrjen e procedurave të fertilizimit artificial/in vitro në institucionet publike dhe jopublike dhe përafrimin rregullator me përvojën ndërkombëtare në këtë fushë.</p>	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	1.Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2.Tryezë e përbashkët/takime me palët e interesuara;
Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar.	Katër-mujori 3/2020	<p>Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor.</p> <p>Amendimi i Ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” synon adresimin e rekomandimeve të raportit të fundit të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) të Këshillit të Evropës (publikuar në Shtator 2019) kryesisht të lidhura me përmirësimin e mbrojtjes ligjore për personat me çrregullime të shëndetit mendor nëpërmjet</p>	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	1.Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2.Tryezë e përbashkët/takime me palët e interesuara

		përmirësimeve në procedurën e trajtimit të pavullnetshëm.		
--	--	-----------------------------------------------------------	--	--